

KDI-ja: INSTITUCIONET ME SISTEME TË BRISHTA TË INTEGRITETIT.

FAQE 4-5



Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) ka shpalosur të mërkurën gjetjet kryesore të vlerësimit të Sistemit të Integritetit Kombëtar në Kosovë për vitin 2023. Ky është vlerësimi i tretë që bëhet në Kosovë pas atyre të vitit 2011 dhe 2015. Edhe pse në Kosovë ekziston një perceptim i gjerë që kuadri ligjor është mjaft i konsoliduar dhe problemet janë vetëm në implementim të tij, në fakt vlerësimi ka evidencuar mangësi në legjislacionin që rregullon funksionimin e institucioneve, sidomos në raport me garantimin e pavarësisë, resurseve dhe mekanizmave të brendshëm të integritetit

INTERVISTË EKSKLUZIVE me Bardhyl Mahmutin: Si u hoq cilësimi i UÇK-së si “organizatë terroriste”? (18)

‘LOJA’ RRETH PËRFAQËSIMIT TË UÇK-SË NË KONFERENCËN E RAMBUJESË

F. 7



KURTI: BE-ja dhe VUÇIOTI E HUMBËN SHANSIN MË 26 TETOR, ISHA I GATSHËM TA NËNSHKRUAJ ASOCIACIONIN

F. 3



NËNSHKRUHET MARRËVESHJA 25.5 MILIONË EURO PËR PËRMIRËSIM TË RRJETIT TË TRANSMISIONIT TË ENERGJISË NGA KOSTT-I

F. 8

RENOVA

PUTZ

Maqedoni Xhepcisht -Tetovë Gurëz-Ferizaj

Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009 +389 44 487 755

E-mail: renova@mt.net.mk

Fax: +389 44 487 200

Mob: +377 44 501 289

PRINCESHA GROUP SH.P.K.

NDËRTIM PROJEKTIM SHITJE

INFO: 049-111-101, 044-511-177

www.princesha-ks.com


Bunjamini

FABRIKA E LLAQEVE

044/256-051 044/367-061 028/532-617

MITROVICË

STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË



PRISHTINA PËRFORCOHET ME GJOKAJN, HUAZON KURTAJN DHE BULLIQIN

F. 10

Kolegji BIZNESI

www.kolegjbiznesi.com

info@kolegjbiznesi.com

030 500 878 | 045 500 878

044 500 878 | 049 500 878

SIGMA

VIENNA INSURANCE GROUP

SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A DEGA KOSOVË

Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë, Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302, E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY Digital Agency

Endrit Shaqiri +38344685122

Internet Website, Marketing...

Kthehet në Apel çështja e vulës dhe e logos së PD-së



TIRANË, 27 DHJETOR - Gjykata e Lartë në Shqipëri të mërkurën nuk ka marrë vendim për çështjen që do ta zgjidhte ngërçin dhe përplasjet brenda Partisë Demokratike, por ka vendosur ta kthejë rastin në Gjykatën e Apelit.

Gjykata e Lartë në Shqipëri vendosi të kthejë për rigjykim në Gjykatën e Apelit çështjen e vulës dhe logos së Partisë Demokratike. Në njoftimin për medie theksohet se Gjykata e Apelit me vendimin që mori në mars të këtij viti "ka lejuar shkelje procedurale që e bëjnë të cenueshëm vendimin e dhënë prej saj".

Gjykata e Apelit vendosi në mars të vitit 2023 që ta kthejë për rigjykim në Gjykatën e Shkallës së Parë çështjen që lidhet me konfliktin e brendshëm në Partinë Demokratike, duke njohur juridiksht se strukturat drejtuese të kësaj partie janë ato që u zgjedhën në kohën kur kjo forcë politike drejtohej nga Lulzim Basha, i cili në mars të vitit të kaluar kishte dhënë dorëheqje.

Sipas Gjykatës së Lartë, Apeli nuk u ka dhënë përgjigje kërkesave të palëve, ndërkohë që ka marrë në shqyrtim çështje të cilat palët nuk i kanë ngritur si pretendime në ankim, dhe që nuk përbëjnë shkak

për prishjen e vendimit dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim.

Për Gjykatën e Lartë, në vendimin e shpallur në muajin mars, Gjykata e Apelit duhet t'i jepte zgjidhje çështjes, ndaj u vendos "prishja e vendimit të Apelit dhe kthimi i çështjes për rishqyrtim në po atë gjykatë, me një trup tjetër gjykues".

Sali Berisha tha se Gjykata e Lartë "nuk u ngrit në lartësinë e misionit të saj që ta rrëzojë vendimin e Apelit". Sipas tij, aktualisht në fuqi është vendimi i shkallës së parë që njeh Berishën kryetar të PD-së.

Partia Demokratike e drejtuar nga Lulzim Basha reagoi ndaj këtij vendimi duke theksuar se kjo çështje do ta gjejë zgjidhjen e duhur ligjore pa vonesat e shkakutara "nga ata që minojnë drejtësinë dhe të tjerët që i tremben forcimit të opozitës".

Situata e paqartë dhe e paqëndrueshme në PD është krijuar pas 21 marsit të vitit 2022, kur Lulzim Basha dha dorëheqje si kryetar i PD-së dhe vendin e tij e zuri Enkelejd Alibeaj.

Më 25 mars të 2022 Gjykata e Shkallës së Parë në Tiranë e njohu si të ligjshëm Kuvendin Kombëtar të thirrur nga Berisha dhe të gjitha

vendimet që u morën prej tij. Ky vendim u apelua nga Enkelejd Alibeaj, si ushtrues detyre i Partisë Demokratike.

Pas humbjes së thellë të Partisë Demokratike në zgjedhjet vendore të 14 majit, ushtruesi i detyrës së kryetarit, Enkelejd Alibeaj, ka dhënë, po ashtu, dorëheqje.

Derisa po pritej vendimi i Gjykatës së Shkallës së Parë, Sali Berisha, thirri në protestë mbështetësit e tij. Në fjalën e tij para protestuesve, Berisha tha se edhe Gjykata e Lartë është një vegël në duart e kryeministrit Edi Rama, ndërsa më së shumti foli për hetimet ndaj tij për rastin "Partizani" sesa për përplasjen brenda PD-së për vulën dhe logon e partisë. "Kjo nuk është betejë e Sali Berishës, ndonëse unë po burgosem në mënyrën më të padrejtë. Kjo është betejë për lirinë e shqiptarëve. Për dinjitetin e tyre apo nënshtrimin e tyre", tha Berisha.

Për mbarëvajtjen e protestës ishin angazhuar forca të shumta të policisë përreth ndërtesës së Gjykatës së Lartë. Berisha u ul për disa minuta në trotuarin para Gjykatës së Lartë, dhe më pas marshoi bashkë me mbështetësit

Për çfarë akuzohet Berisha?

Berisha, 79 vjeç, u akuzua në tetor se kishte abuzuar me pozitën e tij duke e ndihmuar dhëndrin Jamarbër Malltezi të blejë tokë në Tiranë, e cila ishte në pronësi të qytetarëve dhe Ministrisë së Mbrojtjes, si dhe t'i ndërtojë 17 ndërtesa banimi në atë tokë.

Berisha dhe Malltezi i kanë hedhur poshtë akuzat, duke pretenduar se rasti ndaj tyre është i nxitur nga partia në pushtet e kryeministrit Edi Rama, Partia Socialiste.

Prej tetorit, deputetët e Partisë

Demokratike në opozitë i kanë penguar vazhdimisht seancat e Kuvendit për ta penguar, siç e quajnë ata, sundimin tejet autoritar të socialistëve.

Berisha shërbeu si kryeministër i Shqipërisë nga viti 2005 deri më 2013, si dhe si president nga viti 1992 deri në vitin 1997.

Shtetet e Bashkuara në maj 2021 dhe Britania e Madhe në korrik 2022 ia ndaluan Berishës dhe familjarëve të tij të afër të udhëtojnë në këto dy vende për shkak të dyshimeve të përfshirjes së tij në korrupsion.



e tij drejt selisë së Partisë Demokratike, apo siç njihet selia e Rithemelimit.

Gjykata e Posaçme pritet të vendosë për kërkesën e Prokurorisë së Posaçme të Shqipërisë (SPAK), për arrestimin e Berishës për rastin "Partizani". Në kërkesë specifikohet se kërkohet "arrest shtëpie", se duhet të ruhet nga policia dhe se i ndalohet komunikimi me këdo tjetër pos personave me të cilët jeton në banesën e tij në rrugën "Mustafa Matohiti" në Tiranë.

Ndërkaq, Gjykata e Posaçme as më 27 dhjetor nuk mori vendim për kërkesën e SPAK-ut për

masën e arrestit ndaj Berishës. Pas disa kërkesave të avokatëve të tij mbrojtës për t'u njohur me dosjen dhe për të përjashtuar nga trupi gjyqësor, gjykatësen Irena Gjoka, u vendos shtyrja për ditën e enjte, kur do të shpallet vendimi. Para mbështetësve në selinë e partisë që ai drejton, Berisha tha se "askush dhe asgjë nuk më ndan nga ju". Kuvendi i Shqipërisë më 21 dhjetor votoi në favor të kërkesës së Prokurorisë së Posaçme të Shqipërisë (SPAK) për t'ia hequr imunitetin e deputetit ish-kryeministrit Sali Berisha, duke i hapur rrugën arrestimit të tij nën dyshimin për korrupsion.

Dodiku emëron Vulinin senator të Republikës Sërpska

BEOGRAD, 27 DHJETOR - Aleksandar Vulin, ish-ministër në Qeverinë e Serbisë dhe ish-shëf i shërbimit të inteligjencës serbe, është bërë anëtar i ri i Senatit të Republikës Sërpska me vendim të presidentit të Bosnjë-Hercegovinës.

Siç njofton agjencia Srna, Vulin, "bazuar në Kushtetutën e Republikës Sërpska dhe Ligjin për Senatin", është emëruar senator nga 1 dhjetori. Ky vendim, sipas njoftimit, do të publikohet në Gazetën Zyrtare të Republikës Sërpska.

Vendimi për emërimin e Vulinit nuk është publikuar ende në Gazetën Zyrtare dhe as në faqen e presidentit të Republikës Sërpska. Vulin, i cili në dekadën e fundit mbante disa pozita si drejtor i Zyrës për Kosovën në Qeverinë e Serbisë dhe ministër i Mbrojtjes dhe Punëve të Brendshme, më 3 nëntor dha dorëheqje nga pozita e drejtorit të Agjencisë për Siguri dhe Informacion (BIA).

Politikani serb, i cili kryeson partinë Lëvizja Socialiste, që nga

korriku është përfshirë në listën e të sanksionuarve të ShBA-së, për shkak të dyshimeve për korrupsion, përfshirjes në trafikun e drogës dhe lidhjeve me Rusinë.

Pas shpalljes së sanksioneve kundër Vulinit, Dodiku, i cili, gjithashtu, është nën sanksionet e ShBA-së, e mbështeti atë duke thënë se ishte "një shpërblim për patriotizmin dhe këmbënguljen e tij në ruajtjen e marrëdhënieve miqësore me Rusinë dhe popullin rus".



Kurti: BE-ja dhe Vuçiqi e humbën shansin më 26 tetor, isha i gatshëm ta nënshkruaj Asociacionin

EPOKA ERE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 27 DHJETOR - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, në një paraqitje para medieve, ka thënë të mërkurën se liderët e BE-së dhe presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq, e kishin rastin më 26 tetor që ta merrnin nënshkrimin e tij për formimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe. “Unë po ju them gjëra që jua kam thënë edhe më herët, sepse s’ka ndonjë gjë të re këtu që unë të kem përgjigje të reja. Më 26 tetor më është thënë që situata është urgjente, nuk po përfundon agresioni rus në Ukrainë, nisi edhe një luftë në

Lindjen e Mesme, rrjedhimisht është çështje jetike, urgjente, normalizimi i marrëdhënieve. Meqë është ashtu, sonte po e nënshkruajmë. Por ka renditje të dokumenteve për nga rëndësia dhe kronologjia: marrëveshja bazike, aneksi i zbatimit dhe draft-statuti për të cilin unë dy ditë më herët i kisha dërguar vërejtjet e mia. Ata që në Bashkimin Evropian ishin shumë të interesuar, për shembull, për Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe, përkatësisht për draft-statutin e propozuar, e patën shansin. Presidenti i Serbisë që vazhdimisht e përmend Asociacionin, e pati shansin. Por nuk u bë për mungesë të gatishmërisë sime, andaj nuk

ka kuptim të vazhdoni të më pyesni mua edhe më shumë. Pra, duhet të pyeten ata atje pse e humbën atë shans aq të mirë. Unë që isha i gatshëm për nënshkrim, tash a jam serioz? Po ku ka më serioz sesa të thuash eja nënshkruajmë sonte. Më seriozitet se kaq në marrëdhënie ndërkombëtare dhe për marrëveshje ndërkombëtare, nuk ka. Aty joserioziteti i doli palës serbe, që nuk nënshkruan”, ka thënë Kurti. Në konferencën për medie, Kurti, po ashtu, tha se ky vit ka qenë sfidues sidomos në pjesën veriore të Kosovës të banuar me shumicë serbe. Ai përmendi sulmin e një grupi të armatosur serbësh në Banjskë

ndaj Policisë së Kosovës, ndërsa u përgjigj edhe nëse ka informacione për praninë e zyrtarëve të lartë shtetërorë të Serbisë në veri disa ditë para sulmit të 24 shtatorit. “Sa i përket ish-shefit të [Agjencisë serbe të Sigurisë dhe Informacionit, BIA, Aleksandar] Vulin, nëse ka qenë para 24 shtatorit në veri të Kosovës, unë nuk mund ta konfirmoj një gjë të tillë, meqë për herë të parë po e dëgjoj sot. Pra, siç di unë, kjo nuk është e vërtetë, mirëpo ata që pretendojnë asisoj le t’i ofrojnë dëshmitë për informacion ndryshe”, ka thënë Kurti. Ndërkaq ministrja e Punëve të Jashtme dhe e Diasporës, Donika Gërvalla, gjatë

konferencës së përbashkët me Kurtin, tha se “aleatët dhe partnerët tanë e kanë kuptuar se [presidenti serb, Aleksandar] Vuçiqi dhe [presidenti rus, Vladimir] Putini janë të gatshëm për çdo eskalim, përfshirë edhe luftën”. “Si në Bashkimin Evropian, ashtu edhe në Shtetet e Bashkuara dhe Mbretërinë e Bashkuar, janë shtuar zërat që kritikojnë hapur institucionet e BE-së për qëndrime të gabuara në raport me Serbinë dhe mungesën e ndëshkimit për aktin e agresionit të hapur ndaj Kosovës. Qëndrimi i Kosovës në vazhdimësi ka qenë parimor, këmbëngulës dhe i guximshëm”, ka thënë Gërvalla.



Thaçi, Veseli, Selimi dhe Krasniqi shpallen “Qytetarë Nderi” të Drenasit

DRENAS, 27 DHJETOR - Liderët e UÇK-së, Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Rexhep Selimi dhe Jakup Krasniqi, janë shpallur “Qytetarë Nderi” të komunës së Drenasit. Propozimi për t’i shpallur “Qytetarë Nderi” e ka bërë kryetari i Drenasit, Ramiz

Lladrovci dhe është përkrahur nga të gjithë asamblistët e Kuvendit Komunal të kësaj komune. “Propozimi i kryetarit të komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci, për shpalljen ‘Qytetar Nderi’ të komunës së Drenasit për Hashim

Thaçin, Kadri Veselin, Jakup Krasniqi e Rexhep Selimi, është votuar me vota unanime nga anëtarët e Kuvendit të komunës në mbledhjen e rregullt të Kuvendit të mbajtur me datën 27.12.2023”, ka njoftuar komuna e Drenasit.





KDI-ja: Institucionet me sisteme të brishta të integritetit

Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) ka shpalosur të mërkurën gjetjet kryesore të vlerësimit të Sistemit të Integritetit Kombëtar në Kosovë për vitin 2023. Ky është vlerësimi i tretë që bëhet në Kosovë, pas atyre të vitit 2011 dhe 2015. Edhe pse në Kosovë ekziston një perceptim i gjerë që kuadri ligjor është mjaft i konsoliduar, dhe problemet janë vetëm në implementim të tij, në fakt vlerësimi ka evidentuar mangësi në legjislacionin që rregullon funksionimin e institucioneve, sidomos në raport me garantimin e pavarësisë, resurseve dhe mekanizmave të brendshëm të integritetit

EPOKA
ERE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 27 DHJETOR - Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) përmes një konference për medie shpalosi gjetjet kryesore të vlerësimit të Sistemit të Integritetit Kombëtar në Kosovë për vitin 2023. Ky është vlerësimi i tretë që bëhet në Kosovë, pas atyre të vitit 2011 dhe 2015. Sistemi i Integritetit Kombëtar (SIK) është pjesë e qasjes holistike të Transparency International (TI) në luftimin e korrupsionit përmes vlerësimit të bazës ligjore dhe performancës aktuale të institucioneve relevante në sistemin e luftimit të korrupsionit, në aspekte si resurset, pavarësia, llogaridhënia, integriteti, ndërveprimi dhe rolet e tyre. SIK-u vlerëson, pra, efikasitetin e përgjithshëm institucional në luftimin e korrupsionit dhe luftimin e dukurive me abuzimin e pushtetit. “Vlerësimi, i cili është rezultat i një hulumtimi gati dyvjeçar, tregon se përgjatë tetë viteve të

fundit institucionet në Kosovë përgjithësisht kanë shënuar progres në sistemet e tyre të integritetit, veçanërisht lidhur me transparencën dhe masat e llogaridhënies. Shumë prej përmirësimeve të evidentuara në vlerësim kanë ardhur kryesisht si rezultat i presionit publik, kërkesave ndërkombëtare apo zbatimit të zotimeve të marra në kuadër të Agjendës për Reforma Evropiane apo përafrimit të legjislacionit me acquis të BE-së”, bëhet me dije në njoftimin e KDI-së. Sipas këtij njoftimi, edhe pse në Kosovë ekziston një perceptim i gjerë që kuadri ligjor është mjaft i konsoliduar, dhe problemet janë vetëm në implementim të tij, në fakt, vlerësimi ka evidentuar mangësi në legjislacionin që rregullon funksionimin e institucioneve, sidomos në raport me garantimin e pavarësisë, resurseve dhe mekanizmave të brendshëm të integritetit, ashtu edhe në kornizën e përgjithshme ligjore kundër-korrupsion. “Por, është më se e

qartë se të gjitha institucionet kanë probleme me zbatimin e ligjeve dhe përmbushjen e obligimeve dhe rolit të tyre në luftimin e korrupsionit”, theksohet në njoftim. KDI-ja ka vlerësuar se niveli mesatar i integritetit në të gjitha institucionet është vetëm 67 nga 100 pikët e mundshme - pra, një notë mezi kaluese, e që është e pamjaftueshme për të pasur një luftim efikas të korrupsionit dhe qeverisje me integritet. Sipas vlerësimit të SIK-ut, tri institucionet apo shtyllat me nivelin më të lartë të integritetit janë: Zyra Kombëtare e Auditimit (83.3 nga 100 pikë); Avokati i Popullit (79.5 nga 100 pikë) dhe Policia (75 nga 100 pikë). Ndërsa shtyllat apo institucionet që rangohen në fund të listës janë partitë politike (58.3 nga 100 pikë); ndërmarrjet publike (50 nga 100 pikë); dhe bizneset (45.8 nga 100 pikë). “Nëse krahasojmë nivelin e integritetit në tre pushtetet kryesore del se sistemi i drejtësisë prin me 69.7 pikë, pasuar nga ekzekutivi me 65.9 pikë, ndërsa në fund është

legjislativi me vetëm 60.4 pikë. Problemet kryesore që janë evidentuar në këtë raport ndërlidhen me mostrajtimin adekuat të rasteve të korrupsionit nga institucionet e drejtësisë, ndikimin e ekzekutivit dhe aktorëve të tjerë në punën e institucioneve të tjera - përmes ndarjes së buxhetit, deklarimeve publike apo proceseve të rekrutimit; mungesën apo moszbatimin e mekanizmave të integritetit dhe llogaridhënies, si dhe mungesën e transparencës së plotë mbi mënyrën e financimit dhe shpenzimeve të subjekteve politike dhe kandidatëve të tyre. Mungesa e resurseve të mjaftueshme, sidomos financiare, njerëzore dhe infrastrukturore, po ashtu ndikon negativisht në rolin dhe performancën e institucioneve në luftimin e korrupsionit”, thuhet në njoftimin e KDI-së. Marrë parasysh rezultatet e këtij vlerësimi, KDI-ja vlerëson se reformat janë të domosdoshme për t'i adresuar në mënyrë gjithëpërfshirëse sfidat e identifikuar, si në aspekt të resurseve, nivelit të transparencës, llogaridhënies apo mekanizmat të integritetit. “Lidhur me pjesën e resurseve, fokusi i menjëhershëm duhet të jetë në adresimin e mangësive në resurset financiare, njerëzore dhe infrastrukturore nëpër institucione. Alokimi i burimeve adekuate është esencial për optimizimin e performancës së

institucioneve në luftimin e korrupsionit. Parandalimi i ndërhyrjeve dhe ndikimeve të jashtme, veçanërisht atyre politike, janë kritike për ruajtjen e pavarësisë së institucioneve. Kjo vlen veçanërisht në raport me institucionet e sistemit të drejtësisë, të cilëve duhet t'u garantohet pavarësi, sidomos financiare. Ndërsa marrë parasysh performancën e këtyre të fundit në luftim të korrupsionit, nevojitet sa më parë fuqizimi i mekanizmave të llogaridhënies së gjyqtarëve dhe prokurorëve - duke paraparë ndëshkime edhe për performancë të dobët. Procesi i vettingut duhet të garantojë nivele më të larta të integritetit të kërreve të sistemit të drejtësisë”, është thënë në njoftimin e KDI-së. Më tutje theksohet se zbatimi rigoroz i kodeve të mirësjelljes dhe nxjerrja e tyre në institucionet që nuk kanë të tilla duhet të shihet si prioritet për promovimin e masave të integritetit. “Po ashtu, duhet rregulluar me ligj çështja e lobimit tek institucionet apo zyrtarët publikë që kanë fuqi vendimmarrëse. Transparenca në proceset vendimmarrëse duhet të rritet, veçanërisht te Qeveria dhe Kuvendi. Hapja e këtyre proceseve jo vetëm që nxit besimin e publikut, por kontribuon në mënyrë të konsiderueshme në promovimin e një qeverisjeje më të përgjegjshme”, ka theksuar KDI-ja.

Mungesa e ndjekjes penale për rastet e falsifikimit të dokumenteve në prokurim publik

PRISHTINË, 27 DHJETOR - Demokraci Plus (D+) ka publikuar hulumtimin e shkurtër “Mungesa e ndjekjes penale për rastet e falsifikimit të dokumenteve publike në proceset e prokurimit publik”, gjersa thuhet se hulumtimi ka shpërfaqur mungesën e hetimit penal nga prokuroria për rastet e falsifikimit dhe prezantimit të dokumenteve të rreme nga ana e operatorëve ekonomikë në proceset e tenderimit publik. Kjo formë e korrupsionit, përveç që shkel Ligjin e Prokurimit Publik, për të cilën parashihet diskualifikimi apo përfshirja në “Listën e Zezë”, paraqet edhe vepër penale sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës. “Ligji i Prokurimit Publik ndëshkon veprimet si falsifikimi i dokumenteve dhe deklarimi i rremë, dhe obligon Organin Shqyrtues të Prokurimit t’i diskualifikojë operatorët ekonomikë nga pjesëmarrja në aktivitete të prokurimit publik, por duhet pasur parasysh se Kodi Penal i Republikës së



Kosovës i parasheh si vepra penale këto veprime dhe i sanksionon deri në pesë vjet burgim”, ka thënë Egzona Kozhani, hulumtuese e prokurimit publik në Demokraci Plus. Nga 1 janari i vitit 2021 deri më 1 nëntor të vitit 2023, OShP-ja diskualifikoi 30 operatorë ekonomikë nga pjesëmarrja në prokurimin publik, mbi bazën

se këta operatorë ekonomikë kishin paraqitur të dhëna të rreme ose dokumente të falsifikuara. “Numri i operatorëve ekonomikë të diskualifikuar nuk është i lartë pasi bëhet fjalë për një periudhë pothuajse trevjeçare. Autoritetet kontraktuese, të cilat kanë mandat të inicijojnë kërkesa për diskualifikim, hezitojnë të bëjnë këtë edhe në rastet kur

konfirmohen falsifikimet. Përveç kësaj, OShP-ja merr shumë kohë në publikimin e vendimeve, ku në tri rastet e fundit të diskualifikimit i janë dashur mesatarisht 492 ditë që të vendosë për kërkesat”, ka thënë Ardit Dragusha, hulumtues i prokurimit publik në Demokraci Plus. Ai ka theksuar se, përveç numrit të ulët të diskualifikimit, në

Kosovë ekziston edhe një amnisti penale për kompanitë të cilat përfundojnë në Listën e Zezë, ku nga 30 rastet e diskualifikimit gjatë periudhës janar 2021 - nëntor 2023, vetëm shtatë raste janë trajtuar/janë në trajtim nga Prokuroria. Në Kosovë çdo kërkesë për diskualifikim të cilën e aprovon OShP-ja paraqet vepër penale, ndaj mosveprimi i autoriteteve të drejtësisë është inkurajim për operatorët ekonomikë që të përfshihen më tej në këtë sjellje. Me qëllim të luftimit të kësaj forme të korrupsionit, kërkohet një qasje gjithëpërfshirëse dhe prokative, me prokurorinë që duhet të trajtojë dhe ta hetojë secilin rast të diskualifikimit në prokurim publik. Nevoja për hetim penal shërben edhe si rikujtim për operatorët e tjerë ekonomikë, se nuk mund të ketë amnisti penale ndaj praktikave korruptive dhe këto veprime ligjore do ta forcojnë integritetin e procesit të prokurimit publik në përgjithësi.

KQZ-ja pezullon PSD-në dhe Lëvizjen për Bashkëveprim



PRISHTINË, 27 DHJETOR - Komisioni Qendror Zgjedhor (KQZ) ka pezulluar dy subjekte politike, Partinë Socialdemokrate (PSD) dhe Lëvizjen për Bashkëveprim, për shkak të mosmbajtjes së kuvendeve zgjedhore brenda afatit ligjor. Deri te pezullimi ka ardhur me rekomandim të Zyrës për regjistrimin, certifikimin dhe kontrollin financiar të partive politike (ZRCKFPP), pasi që afati i fundit për mbajtjen e Kuvendit

Zgjedhor për Lëvizjen për Bashkëveprim ka qenë data 8 dhjetor 2023, ndërsa për PSD-në më 15 dhjetor 2023. Drejtori i Zyrës për regjistrim, certifikim dhe kontrollin financiar të partive politike në KQZ, Besnik Buzhala, lidhur me pezullimin e PSD-së, tha se më 18 dhjetor kanë përgatitur rekomandimin dhe e kanë dërguar te KQZ-ja për shqyrtim. Ai shtoi se PSD-ja më 12 dhjetor

ka bërë kërkesë që ta mbajë kuvendin më 28 janar, për çka tha se e kanë trajtuar këtë kërkesë. Sipas Rregullores për regjistrimin dhe funksionimin e partive politike, KQZ merr vendim për çregjistrim nga regjistri i partive politike në Kosovë nëse partitë nuk përmbushin obligimet e tyre ligjore edhe pas afatit shtesë prej 45-ditësh.

Vendimi për pezullim, sipas kryetarit të PSD-së, Dardan Molliqaj është “qasje shantazhuese dhe e dëmshme për organizimin politik”. Ai tha se Kuvendi i PSD-së pritet të mbahet më 28 janar dhe, sipas tij, për të është njoftuar Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. “Procedimin me pezullim nuk mund ta shohim ndryshe pos si dashakeqësi ndaj PSD-së. Një qasje e tillë formaliste e

shantazhuese është e dëmshme për organizimin politik dhe s’duhet të pranohet në asnjë mënyrë”, ka shkruar Molliqaj në “Facebook”. Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme në Kosovë përcakton që të gjitha partitë politike të regjistruara janë të obliguara ta mbajnë Kuvendin Zgjedhor brenda gjashtë muajve nga data e regjistrimit të partive, pastaj së paku çdo 48 muaj.

Gjykata Kushtetuese i shpall të pavlefshme disa nene të Ligjit për Paga



PRISTINË, 27 DHJETOR - Gjykata Kushtetuese e Kosovës ka njoftuar se i ka shpallur të pavlefshme disa nene të Ligjit për Paga në sektorin publik, duke e pranuar kërkesën e Avokatit të Popullit për kushtetutshmërinë e këtij ligji. Në një njoftim për medie,

Kushtetuesja tha se “paragrafët 2, 3 dhe 4 të nenit 41, për shtesat tranzitore, dhe paragrafi 2 i nenit 45 (shfuqizimi i Ligjit për Presidentin e Republikës së Kosovës) të ligjit të kontestuar, shpallen të pavlefshëm me hyrjen në fuqi të aktgjykimit”.

Ajo theksoi se vendimi i saj nuk i prek “në asnjë mënyrë” zyrtarët dhe nëpunësit të cilëve u është ngritur niveli i pagës përmes Ligjit për Paga. Gjykata ka urdhëruar Kuvendin që në periudhën prej gjashtë muajsh pas hyrjes në fuqi të

vendimit të saj, t'i ndryshojë apo t'i ndryshojë plotësisht nenet e lartcekura në pajtim me Kushtetutën.

Ligji për Paga në sektorin publik u miratua nga Kuvendi i Kosovës në dhjetor 2022, ndërsa vlera e koeficientit prej 105 eurosh u miratua në shkurt 2023.

Me Ligjin e ri për Paga, niveli i koeficienteve është nga 2 deri në

18. Presidentit së shtetit i është caktuar koeficienti më i lartë. Ligji për Paga zbatohet për punonjësit e sektorit publik, pagat e të cilëve financohen nga buxheti i shtetit, me përjashtim të punëtorëve të Agjencisë Kosovare për Inteligjencë (AKI).

Janë rreth 83 mijë punonjës të sektorit publik që marrin pagë nga buxheti i shtetit.

Neni 41: Shtesa tranzitore

1. Nëse një zyrtar/e publik/e apo funksionar/e publik/e, para hyrjes në fuqi të këtij ligji përfitonte pagë që është më e madhe se paga e plotë e parashikuar me këtë ligj, ajo/ai do të përfitojë pagën e re sipas dispozitave të këtij ligji dhe shtesën tranzitore të barabartë me diferencën ndërmjet pagës aktuale dhe pagës së re bazë.

2. Të punësuarat/it, zyrtarja/i publik/e apo funksionarja/i publik/e, në pajtim me paragrafin 1. të këtij neni, do të përfitojë pagën e re në: 2.1. 100% të shtesës tranzitore të posaçme, sipas paragrafit 1, gjatë vitit të parë pas hyrjes në fuqi të këtij ligji; 2.2. 50 % të shtesës tranzitore të posaçme, sipas paragrafit 1, gjatë vitit të dytë pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.

3. Përfshirë nga paragrafi 1. dhe 2. i këtij neni, anëtarët/ët e shërbimit të jashtëm nuk gëzojnë të drejtën e shtesës tranzitore.

4. Çdo person që punësohet pas miratimit të këtij ligji përfiton pagën sipas këtij ligji dhe nuk gëzon të drejtën e shtesës tranzitore.

Kurti: Vendimi për targa, pasi të vërtetohet zbatimi nga Serbia

PRISTINË, 27 DHJETOR - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, tha se pasi Policia e Kosovës do të vërtetojë që Serbia po e zbaton të plotë dhe pa pengesa vendimin për pranimin e targave të Republikës së Kosovës, ekzekutivi i Kosovës do ta marrë vendimin “e barasvlershëm si çështje e marrëdhënieve reciproke ndërshtetërore”.

Në mbledhjen e qeverisë, më 27 dhjetor, Kurti tha se Serbia po e përdor çështjen e targave për ta ulur presionin ndërkombëtar ndaj saj, si dhe “për ta maskuar dështimin e tyre në Banjskë më 24 shtator”.

Drejtori i Zyrës për Kosovën në Qeverinë e Serbisë, Petar Petković, ka thënë më 25 dhjetor se Qeveria e Serbisë ka marrë një vendim që do ta mundësojë lëvizjen e lirë të të gjitha automjeteve nga Kosova në territorin e Serbisë. “... ky veprim i Serbisë që, më shumë se konstruktiv dhe hap drejt normalizimit, është një manovër e radhës jo për hir të shtetit serb, kurrësi të Kosovës, për hir të pushtetit në Beograd”, tha Kurti në mbledhjen e qeverisë.

Për një gjë të tillë, Serbia ishte pajtuar me marrëveshjen e vitit 2011, të arritur mes përfaqësuesve të Kosovës dhe Serbisë në dialogun e ndërmjetësuar nga Bashkimi Evropian. “Qëndrimi ynë sa i përket çështjes së targave ka qenë i mbështetur në parimin e reciprocitetit. Do të vazhdojmë të jemi parimorë dhe konstruktivë. Vendimin tonë të barasvlershëm si çështje e marrëdhënieve reciproke ndërshtetërore do ta

marrim sapo policia jonë kufitare të dokumentojë dhe vërtetojë se Serbia po e zbaton të plotë dhe pa pengesa vendimin e saj. Ne besojmë se kjo qasje është drejtë përveçse e arsyeshme”, tha Kurti të mërkurën.

Duke folur për vendimin e Serbisë për pranimin e targave RKS, Kurti tha se një vendim i tillë po vjen “pas një moszbatimi më shumë se 10-vjeçar të marrëveshjeve paraprake”. Ai tha se Serbia e ka përdorur çështjen e targave fillimisht për ta tensionuar situatën e sigurisë në veri të Kosovës, ndërsa tani, sipas tij, po e përdor për t'i ulur kritikën nga Perëndimi pas “parregullsive dhe mashtrimeve në zgjedhjet e dhjetorit atje”. “[Targat] po përdoren për ta ulur presionin nga Perëndimi, Bashkimi Evropian, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, mbi Serbinë për zgjedhje jo të rregullta dhe jodemokratike, për ta mbuluar refuzimin zyrtar të marrëveshjes bazike në Bruksel, që e ka bërë letra e kryeministres së Serbisë, [Ana] Bernabiq, drejtuar Këshillit Evropian më 13 dhjetor, dhe për ta maskuar dështimin e tyre në Banjskë më 24 shtator”, tha Kurti.

Bashkimi Evropian e ka mirëpritur vendimin e Serbisë që brenda territorit të saj ta lejojë qarkullimin e lirë të veturave me targa të Kosovës, RKS – Republika e Kosovës, duke e cilësuar hap pozitiv drejt normalizimit të raporteve.

BE-ja pret që edhe Kosova të ndërmarrë një vendim të ngjashëm, tha zëdhënësi Peter



Stano. “Ne mirëpresim vendimin e Serbisë që zyrtarisht t'i njohë targat e automjeteve RKS të lëshuara nga Kosova. Ky vendim është hap pozitiv në zbatimin e Marrëveshjes në rrugën drejt normalizimit, por edhe zotimeve të mëparshme në kuadër të dialogut për lirinë e lëvizjes. Kjo dëshmon se përparimi në procesin e normalizimit të raporteve në mes të Kosovës dhe Serbisë është i mundur”, tha Stano në një përgjigje me shkrim.

Bashkimi Evropian, gjithashtu, vlerësoi se vendimi për targat është një hap i duhur drejt

integritit më të mirë evropian të Ballkanit Perëndimor. “Ky vendim hap rrugën për heqjen e plotë të regjimit të letrave ngjitëse [sticker]. BE-ja tani pret që Kosova të përgjigjet në mënyrë të ngjashme”, shtoi Stano.

Para praktikës së letrave ngjitëse, automjetet me targa RKS detyroheshin të merrnin targa provuese në kufirin me Serbinë, që vlenin 60 ditë dhe kushtonin 5 euro. Por, më 20 shtator të vitit 2021, Qeveria e Kosovës vendosi masën e reciprocitetit, që i detyroi edhe shoferët nga Serbia ta kalonin të njëjtën procedurë për të

hyrë në Kosovë. Por, kjo masë nxiti pakënaqësi në mesin e popullatës serbe në Kosovë, e cila bllokoj rrugët që çonin në pikat e kalimeve kufitare me Serbinë, në Jarinjë dhe Bërnjak.

Për t'i ulur tensionet, me ndërmjetësimin e bllokut, më 30 shtator 2021 u arrit një marrëveshje e përkohshme për targat. Kjo marrëveshje bëri që shoferët me targa të Kosovës dhe me ato të Serbisë të vendosnin letra ngjitëse në simbolet shtetërore në targa sa herë që kalonin kufirin e këtyre dy shteteve.

Ismaili: Qeveria dhe ZRRE-ja ta nisin urgjentisht procesin e uljes së çmimit të energjisë elektrike



Nënkryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Uran Ismaili, ka kërkuar nga qeveria Kurti dhe Zyra e Rregullatorit të Energjisë ta ulin çmimin e energjisë elektrike për qytetarët e Kosovës. Sipas tij, ngritja e çmimit të energjisë elektrike i ka vënë qytetarët para një vështirësie të madhe financiare duke ua shpenzuar buxhetin familjar para festave të fundvitit. “Është kërkesë imediate që qeveria, bashkë me ZRRE-në, ta fillojnë urgjentisht procesin e uljes së çmimit të energjisë elektrike si dhe të mbahen përgjegjës para ligjit të gjitha aktorët që kanë abuzuar me situatën në sektorin e energjisë”, ka pohuar ai

janë qytetarët tanë, të cilat vijnë si rrjedhojë e skandaleve dhe politikave të kësaj qeverie në energji”, ka thënë ai. Po ashtu, ai rikujtoi se me qeverinë Kurti në pushtet, ambasadori i Republikës së Kosovës në Kroaci, Martin Berishaj, është përfshirë në skandalin më të madh rajonal të tregtimit të energjisë dhe shpëlarjes së parave, së pari është dyfishuar çmimi i energjisë, pastaj ka ndodhur edhe ngritja e dytë prej 15.4 %. “Kjo qeveri, edhe pse sot çmimi i energjisë në bursën

ndërkombëtare ka rënë nga mesatarisht 300 euro në vitin e kaluar, në 21 euro për megavat, prapëseprapë nuk e ka marrë asnjë vendim për t’i zbritur tarifat e energjisë për qytetarët tanë, por kanë mbajtur çmime shumë të larta aktuale. Kjo qeveri i ka dhënë 113 milionë euro nga taksat tona për ta paguar energjinë e serbëve në pjesën veriore të vendit. Kjo qeveri nuk ka bërë asgjë për ndërtimin e kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë. Përkundrazi, ajo ka hequr dorë

edhe nga projekti i gazit amerikan, që do ta ndihmonte shumë sigurinë energjetike të vendit, rrjedhimisht edhe ekonomitë familjare të Kosovës. Si përfundim, kjo qeveri, fatkeqësisht, nuk e ka as në temë, as në plan dhe as në agjendë mbështetjen e ekonomive familjare dhe prodhimin vendor energjetik. Barrën e energjisë elektrike të ngritur do ta paguajnë edhe për një kohë të gjatë qytetarët e vendit tonë”, ka theksuar nënkryetari i PDK-së, Uran Ismaili.

EPOKA ERE Mal QORRAJ

PRISHTINË, 27 DHJETOR - Nënkryetari i Partisë Demokratike të Kosovës, Uran Ismaili, ka kërkuar nga qeveria Kurti dhe Zyra e Rregullatorit të Energjisë ta ulin çmimin e energjisë elektrike për qytetarët e Kosovës. Ismaili, në një konferencë për medie, tha të mërkurën se faturat e dyfishuara ose të trefishuara mujore, apo edhe më të larta të energjisë që i kanë pranuar qytetarët gjatë kësaj jave, janë të padrejta dhe të papërbalueshme. “Andaj është kërkesë imediate që qeveria, bashkë me ZRRE-në, ta fillojnë urgjentisht procesin e uljes së çmimit të energjisë elektrike, si dhe të mbahen përgjegjës para ligjit të gjitha aktorët që kanë abuzuar me situatën në sektorin e energjisë. Sepse vazhdimi i faturimit të energjisë me tarifat aktuale do të jetë rrënues për familjet në Kosovë”, ka thënë ai. Sipas Ismailit, ngritja e çmimit të energjisë elektrike i ka vënë qytetarët para një vështirësie të madhe financiare, duke ua shpenzuar buxhetin familjar para festave dhe duke i futur në borxhe familjet e Kosovës vetëm që ta përballojnë muajin. “Këtë muaj pamë një politikë të qeverisë kinse

për t’i ndihmuar qytetarët. Ato 58 milionë euro që u ndanë si subvencione nga qeveria për fëmijë dhe pensionistë, po dëshmohet se kanë qenë mjete të ndara për KEDS-in. Qytetarët vetëm janë përdorur si ndërmjetësues në këtë transaksion të planifikuar. Faturat e stër-rritura të energjisë janë dëshmi e kësaj politike të dëmshme dhe manipuluese. Në kohën kur qytetarët e Kosovës, nën këtë qeveri, janë varfëruar edhe më shumë, me 19 % e tyre nën pragun e varfërisë, ata po detyrohen t’i paguajnë edhe faturat më të shtrenjta të energjisë elektrike”, ka shtuar ai. Ismaili rikujtoi dy deklaratat kontradiktore të kryeministrit Kurti, atë të vitit 2015, se qytetarët më të varfër në Evropë po i paguajnë faturat më të shtrenjta të energjisë elektrike, si dhe atë të vitit 2022, se aq lirë ka qenë energjia elektrike sa qytetarët nuk e kanë ditur se sa paguajnë. “Ani pse e kanë të njëjtin burim, këto dy deklarata shpërfaqin jo vetëm ndryshimin nga opozita në pushtet, por dhe qëllimin e kësaj qeverie për ta dyfishuar çmimin e energjisë për qytetarët e Kosovës. Pra, ekziston një përgjegjësi e drejtpërdrejtë qeveritare për situatën e vështirë në të cilën sot



Komandanti i FKS-së dekorohet me medaljen për “Shërbim të shquar”

PRISHTINË, 27 DHJETOR - Ministri i Mbrojtjes, Ejup Maqedonci, ka dekoruar komandantin e FSK-së, gjenerallejtënant Bashkim Jashari, me medaljen “Shërbim i shquar”. “Në shenjë vlerësimi për angazhimin shumëvjeçar në mbrojtjen dhe sigurinë e

vendit, punën e jashtëzakonshme në udhëheqjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës, përkushtimin e treguar në implementimin e Planit Gjithëpërfshirës të Tranzicionit dhe avancimin e kapaciteteve profesionale dhe

operacionale të FSK-së, ministri Maqedonci sot ka dekoruar me medalje për ‘Shërbim të shquar’ komandantin e Forcës së Sigurisë së Kosovës, gjenerallejtënant Bashkim Jashari”, ka njoftuar Ministria e Mbrojtjes.

Ministri Peci: Viti 2023, më i suksesshmi për bujqësinë

PRISHTINË, 27 DHJETOR - Ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR), Faton Peci, e ka quajtur vitin 2023 të suksesshëm për bujqësinë.

Në konferencën përmbyllëse të vitit, Peci ka thënë se këtë vit 31 mijë fermerë kanë përfituar në kuadër të subvencioneve në vlerë mbi 61 milionë euro.

Ndërsa janë miratuar 491 projekte të granteve në vlerë prej 24.2 milionë eurosh. “Nëse vitit 2023 i vendosim një shifër për bujqësinë, ajo është vlara prej 85 milionë eurosh përmes së cilës është shpërblyer puna dhe mundi i bujkut tonë të vyer. Në kuadër të kësaj janë miratuar 491 projekte të granteve në vlerë prej 24.2 milionë eurosh, ndërsa 31 mijë është numri i përfituesve të subvencioneve në vlerë mbi 61 milionë euro. Viti që po lëmë pas ka qenë viti më i suksesshëm për sektorin e bujqësisë, një vit i mbarë dhe i begatisë. Ky vit është sinonimi i rekordeve në disa sfera si në të mbjella, në mbështetje ndaj fermerëve si dhe në rritje të numrit të përfituesve në programet mbështetëse të ministrisë”, u shpreh Peci.



Ministri Peci ka folur edhe për përkrahjen që ky dikaster u ka dhënë bujqve, duke sqaruar se sipërfaqet e mbjella janë rritur

për 63 për qind, ndërsa është shënuar rritje e eksportit të produkteve bujqësore për 29 % krahasuar me vitin e kaluar për të njëjtën periudhë kohore.

Ai ka folur edhe për ratifikimin e marrëveshjeve në Kuvend. “Kemi ratifikuar në Kuvend marrëveshjen në mes të Qeverisë së Kosovës dhe

Qeverisë së Gjermanisë në vlerë prej 20.2 milionë eurosh për grante në agroturizëm, ekoturizëm dhe zhvillim rural, nga të cilat 10.2 milionë janë financim i Qeverisë së Gjermanisë. 9.2 milionë euro është vlara e grantit nga Komisioni Evropian për investime dhe ngritje të kapaciteteve në sistemin e ujitjes për vitet e ardhshme. Ndërsa 7 milionë është vlara me të cilën do të përkrahet Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë, për procesin e akreditimit që do të fillojë gjatë janarit/shkurtit të vitit 2024. Kjo do t'i mundësojë fermerit të Kosovës që nga viti 2026 të ketë qasje në fonde nga 50 milionë deri në 100 milionë euro krahas buxhetit vendor. Për të dytin vit me radhë jemi ballëhapur përballë fermerëve duke paguar deri në centin e fundit obligimet kontraktuale ndaj tyre. 7.2 milionë është vlara me të cilën kemi mbështetur gratë fermere në kuadër të Programit për Zhvillim Rural, kemi thjeshtuar kriteret e aplikimit në Programet Mbështetëse duke shtuar numrin e kontrolleve në teRren”, u shpreh ai.

Nënshkruhet marrëveshja 25.5 milionë euro për përmirësim të rrjetit të transmisionit të energjisë nga KOSTT-i

PRISHTINË, 27 DHJETOR - Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe KOSTT-i kanë nënshkruar marrëveshje në vlerë 25.5 milionë euro për përmirësim të rrjetit të transmisionit të energjisë nga KOSTT-i.

Në ceremoninë e nënshkrimit ishin ministri i Financave, Punës dhe Transfereve, Hekuran Murati, zëvendësambasadori i Gjermanisë në Kosovë, Matthias Conrad, zëvendësministri i Ekonomisë, Getoar Mjeku dhe kryeshefi ekzekutiv i KOSTT-it, Evetar Zeqiri. Në fjalën e tij hyrëse, ministri Murati theksoi rëndësinë e këtij projekti duke thënë se “projekti parasheh investime në zëvendësimin e nënstacioneve të linjave kyçe të tensionit për operim të sigurt e të qëndrueshëm të sistemit të transmisionit të energjisë nga KOSTT”.

Zëvendësambasadori Conrad ka deklaruar se projekte si ky për përmirësimin e rrjetit të



transmisionit janë të rëndësishëm për integrimin e Kosovës në tregjet e energjisë së Bashkimit Evropian. Në këtë linjë, zëvendësministri Mjeku ka shprehur se përkrahja e ofruar për KOSTT-in mundëson që kostoja e energjisë të jetë e përbalueshme për qytetarët duke i kontribuar edhe procesit të dekarbonizimit.

Se ky projekt është shumë i rëndësishëm u pajtua edhe kryeshefi ekzekutiv i KOSTT i cili tha se: “përmes projektit mundësohet integrimi i një kapaciteti shtesë të energjisë në Deçan, zëvendësimi i transmetuesve ashtu që të zvogëlohet ngarkesa si dhe digjitalizimi i shërbimeve të ofruara nga KOSTT”.

Duke nënvizuar mundësitë për bashkëpunim në projekte të tjera të përbashkëta për zhvillimin e sektorit të energjisë, palët më pas proceduan me nënshkrim të marrëveshjes.

Diaspora dorëlibër, dërgoi 1 miliard e 217 milionë euro për 11 muaj

PRISHTINË, 27 DHJETOR - Gjatë muajit nëntor mërgimtarët shqiptarë kanë dërguar 101.3 milionë euro remitanca. Por për 11 muaj dërgesat financiare

të diasporës shkojnë në 1 miliard e 217 milionë euro, sipas raporteve preliminare të Bankës Qendrore të Kosovës. Krahasuar me 11 muajt e vitit

paraprak, është regjistruar rritje prej 10.2-përqindësh. Derisa vetëm për muajin nëntor nga 101.3 milionët, 65 për qind e tyre janë dërguar

përmes institucioneve financiare jobankare, 19 për qind nga kanale të tjera dhe 16 për qind e mjeteve janë transferuar përmes bankave.



fëmijërinë e tij. Ka kryer shkollimin në medrese, kreu edhe detyrën e imamit dhe kadiut (gjykatësit), madje thuhet se ka qenë edhe mësimdhënëës në medrese. Për shkak të këtyre detyrave që kreu, me kalimin e kohës mori edhe titullin “Hoxhë”. Informatat në lidhje me jetën e Nastradin Hoxhës me kohë janë përzier me gojëdhënat popullore dhe për të thuhet se kishte veçori të jashtëzakonshme. Gomari në barsoletat e tij, në të vërtetë është simboli i qëndresës ndaj dhimbjes, vështirësive dhe urisë. Nastradin Hoxha, duke e përdorur simbolin e gomarit, njerëzve u përcillte mësim nga toleranca.

Një ditë, Nastradin Hoxha dëshironte t’u jepte një mësim të mirë fshatarëve, të cilët torturojnë kafshët e tyre me barra të rënda, ndaj ai me një thes të rëndë në supe hipën mbi gomarin e tij. Fshatarët habiten kur e shohin Hoxhë Nastradinin me thesin mbi supe hipur mbi gomarin e tij dhe e pyesin: “Si është kjo punë kështu, ti hipur mbi gomar dhe mbanë thesin mbi kurriz”? Nastradini me mendjemprehtësinë e tij, përgjigjen e ka të gatshme: “Kafsha e shkretë është duke më shërbyer ditë e natë. Pas të gjitha këtyre punëve të rënda, nuk desha ta ngarkoj edhe me këtë thes të rëndë, për këtë arsye unë e

bartë thesin mbi shpinën time”!

Njerëzit qeshën!

Përgjigjet me humor të Nastradin Hoxhës për ngjarjet ditore të zakonshme, kanë arritur deri në ditët tona. Edhe pse Nastradini nuk ka lënë pas ndonjë vepër të shkruar, humori i tij është transmetuar gojarisht deri në ditët tona prej shekullit XIII. Dihet se tregimi i parë i shkruar në lidhje me Nastradin Hoxhën, është shkruar në veprën e titulluar “Saltukname” të Ebul Hajr Rumiut në vitin 1480. Saltukname është një vepër e shkruar gjatë një periudhe 7-vjeçare, në të cilën janë mbledhur traditat gojore të turqve. Duke filluar prej shekullit të 16-të, barsoletat e Nastradin Hoxhës janë përmbledhur në libra të ndryshëm. Njëra prej këtyre librave më të vjetra është edhe “Hikajeti Kitabı Nastradin”, që është shkruar në vitin 1571. Botimi i parë i barsoletave të Nastradin Hoxhës është libri i titulluar, “Letaif”, që u botua në vitin 1837. Ndërsa libri i parë i ilustruar me figurën e Nastradin Hoxhës, u botua në vitin 1869. Në bibliotekat e ndryshme të botës, ndodhen gjithsej 68 libra në lidhje me Nastradin Hoxhën, ku 12 prej tyre gjinden në Turqi. Ndërkaq në ditët e sotme barsoletat e tij janë përkthyer në shumë gjuhë të botës.

Barsoletat e Nastradin Hoxhës

kaluan kufijtë e kohës, duke arritur edhe deri në Ballkan, në Azinë e Mesme, në Afrikën e Veriut dhe në Evropë – kryesisht edhe në Itali. Shumë barsoleta që tregohen mes popullit në Sicili, janë të frymëzuara nga Nastradin Hoxha. Shumica e popujve në Lindjen e Afërt, Lindjen e Mesme dhe Azinë e Mesme, Nastradin Hoxhën e kanë njohur dhe e kanë përvetësuar me emra të ndryshëm. Arsyeja e popullaritetit kaq të madh të Nastradinit mes popujve të ndryshëm të botës është se jeta dhe humori i tij popullor janë shtrirë në shumë vende ku ai i ka shkelur me gomarin e tij, por dhe në shumë të tjera humori i tij është transmetuar gojarisht, duke u bërë pjesë e trashëgimisë popullore.

Nastradin Hoxha në barsoletat e tij kritikon shoqërinë, individët, madje edhe veten dhe duke ofruar zgjidhje për probleme të ndryshme; ai gjithmonë e jep mesazhin e tolerancës, optimizmit, vëllazërisë dhe paqes. Me personalitetin e tij të mprehtë, Nasradin Hoxha është dijetar i përjetshëm i cili i tregon njerëzve rrugën e vërtetë.

Organizata e Kombeve të Bashkuara për Arsimin, Shkencën dhe Kulturën, UNESCO, vitin 1996 e shpalli si Viti i Nastradin Hoxhës dhe me këtë rast janë shtuar edhe studimet në lidhje me këtë personalitet të humorit. Ndërkaq,

viti 2008 është pranuar si 800-vjetori i lindjes së Nastradin Hoxhës dhe në këtë vit u organizuan aktivitete të ndryshme. Ndërkohë, nuk duhet harruar edhe Konkursi Ndërkombëtar i Karikaturës kushtuar Nastradin Hoxhës, që organizohet çdo vit.

Një ditë, një grup njerëzish e ndalin Nastradin Hoxhën që ishte duke kaluar aty pranë dhe e pyesin se: “Ku ndodhet Qendra e Botës”? Hoxhë Nastradini largohet disa hapa prej tyre dhe shkopin e tij e ngulit në tokë dhe iu thotë:

– Ja këtu është Qendra e Botës.

– Si është e mundur të besohet!? – pyesnin njerëzit të habitur. Ndërsa Nastradini iu përgjigj:


– Nëse nuk më besoni, mund t’a matni ...

Nëse dëshironi që këmba e juaj të shkelë në “Qendër të Botës”, atëherë mund të vizitoni tyrben e Nasradin Hoxhës që ndodhet në Akshehir, ku është dhe pllaka me mbishkrimin “Qendra e Botës”. Të japim edhe një informatë tjetër për lexuesit tanë që nuk besojnë. Shoqata e Nastradin Hoxhës, në vitin 2007 ka marr – nga Instituti i Patentave të Turqisë – certifikatën ku shkruhet: “Akshehiri Qendra e Botës”.

Nga koha që Nastradini vdiq në Akshehir në vitin 1284, kanë kaluar disa shekuj, megjithatë koha tepër e gjatë nuk e ka vjetruar gazin dhe humorin e tij aq

popullorë. Nastradini dhe historitë humoristike të tij janë ende të gjalla në jetën e popullit turk. Edhe sot në kohë të reja, në Akshehir dhe në gjithë trevën e Anadollit bisedohet e diskutohet shumë për historitë humoristike të Nastradinit, duke e bërë atë një figurë shumë të njohur e aktuale. Në Akshehir ka dhe një komunitet të gjerë shqiptarë, shumica e të cilëve janë me prejardhje nga Kosova. Disa prej tyre e kanë ditur se Nastradini ishte nga trojet tona, por kur erdhën në Anadoll e mësuan se ai paska qenë turk dhe jo sulltan apo pasha, por i thjeshtë, dora jonë, dhe se ajo thjeshtësi e bente të ulej fshatçe në odat e burrave dhe bente gaz me ta.

Kjo është historia e vërtetë e këtij personazhi legjendë, që mbas shumë shekujsh të ekzistencës së tij është ende i pranishëm edhe në bisedat tona të viseve shqiptare me shprehjet: “Gomari i Nastradinit”, “Gozhda e Nastradinit”, “Muri i Nastradinit” dhe shumë legjenda e përralla që lidhen me bëmat humoristike të këtij kalorësi që ka shkelur e ka lënë gjurmë edhe në trojet tona dhe jo siç ka qenë tradita si kalorës me kalë, por me gomarin e tij që njerëzit e përfytyrojnë të hipur mbrapsht, duke lënë pas historitë e tij të humorit popullorë që nuk janë shuar dhe sot e kësaj dite!



2024 | Viti i zgjedhjeve të rrezikuara nga Inteligjenca Artificiale



Bëhuni gati për turbulenca. Bëhuni gati, sepse viti 2024 do të jetë viti më i ngarkuar i zgjedhjeve në historinë e fundit botërore. Përqendrimi është vërtet mbresëlënës. Në qershor, në 27 shtetet e Bashkimit Evropian, 427 milionë votues do të shkojnë në kutitë e votimit për të rinovuar Parlamentin e Brukselit, ndërsa në nëntor 200 milionë amerikanë do të zgjedhin pasardhësin e Joe Bidenit. Në maj do të ketë zgjedhje legjislative në Indi, Britaninë e Madhe dhe Afrikën e Jugut, tre vende të cilat së bashku kanë mbi një miliard votues. Më pas do të jetë radha e Meksikës dhe Indonezisë dhe dy demokracive më të brishta si Venezuela dhe Pakistani. Dhe gjithashtu do të ketë votime në Tajvan, ishulli i vogël me 19 milionë votues, pavarësia e të cilit, e kërcënuar prej kohësh nga Kina, po shkakton shqetësimet më të forta globale.

Rezultati i kësaj mbivendosjeje zgjedhore është i paprecedentë dhe tronditës: midis janarit dhe nëntorit, në atë që ne e quajmë “bota e lirë”, mbi dy miliardë njerëz do të thirren për të votuar. Pa harruar dy palë zgjedhje të tjera, të ndryshme dhe të veçanta në mënyrën e tyre, që përfshijnë Ukrainën dhe Rusinë. Pavarësisht luftës dhe pavarësisht pezullimit të votimeve me ligjin ushtarak, në Kiev Volodymyr Zelensky po luan me idenë e mbajtjes së zgjedhjeve presidenciale në mars 2024 dhe zgjedhjeve legjislative në tetor. Ndërsa në mars do të votohet në anën tjetër të barrikadës, në

Moskë: këtu, megjithatë, një tjetër konfirmim i presidencës së Vladimir Putinit është edhe më i sigurt se në të kaluarën, falë shtypjes së lirive në 20 muajt që kanë kaluar nga pushtimi i Ukrainës.

Problemi, natyrisht, nuk ka të bëjë me përqendrimin elektoral por presioni i panevojshëm që autokracitë e mëdha, veçanërisht vetë Federata Ruse dhe Kina, do të ushtrojnë mbi shumicën, në mos të gjitha zgjedhjet e 2024-ës. Vota demokratike rrezikon të ndotet kudo nga “fake news” dhe të ndikohet në distancë, nga propaganda e rrjeteve sociale.

Kjo ka ndodhur tashmë në të kaluarën, por në vitin 2024 interesi i Pekinit dhe Moskës për të ndikuar në opinionet publike të thirrura për të votuar është edhe më i lartë. Mendoni vetëm për zgjedhjet evropiane, të cilat sipas të gjitha sondazheve mund të rrëzojnë mazhorancën e qendrës së majtë, që ka qenë në krye të Parlamentit të Brukselit për dekada, dhe ta zhvendosin boshtin shumë më në të djathtë. Mendoni për polarizimin politik që ka helmuar Shtetet e Bashkuara që nga viti 2016, dhe në më pak se 10 vjet ka krijuar ndarje të papajtueshme midis votuesve demokratë dhe republikanë dhe mund t'i shndërrojë zgjedhjet e ardhshme presidenciale në një konflikt të ngjashëm me sulmin në Kapitol Hill në janar 2021.

Por dy autarkitë e mëdha kanë gjithashtu një interes specifik për të luajtur me paqartësinë e Indisë

apo Indonezisë, dy vende aktualisht në një ekuilibër të pasigurt midis aleancës me Uashingtonin dhe Pekinin.

Dhe rreziku i ndërhyrjes së jashtme nuk përfshin vetëm ngjarje të mëdha elektorale, ato me qindra miliona votues. Çdo palë zgjedhje të vitit 2024 kanë vlerë strategjike. Afrika e Jugut mund të braktisë rolin e saj tradicional si një komb “i paangazhuar” për të vazhduar afrimin e saj me Republikën Popullore të Kinës. Ndërsa Meksika dhe Venezuela mund të shndërrohen në dy fuçi baruti sociale, paqëndrueshmëria politike e Pakistanit rrezikon ta bëjë atë një qendër të re globale për terrorizmin islamik.

Edhe më vendimtar, është fati politik i Tajvanit të vogël, ekonomia e të cilit prodhon 80 për qind të mikroprocesorëve të përdorur në botë dhe ka qenë prej kohësh në qendër të synimeve strategjike-ushtarake të Xi Jinping, i cili do të donte ta gëlltiste ishullin. Në Taipei, themeluesi i gjigantit elektronik Foxconn, miliarderi Terry Gou, po kandidon për zgjedhjet presidenciale janarin e ardhshëm, duke premtuar se do të “rregullojë marrëdhëniet ndërmjet ngushticës”. Me pak fjalë, Gou prezantohet si kandidati i Pekinit. Dhe nuk është e vështirë të imagjinohet se sa presion do të ushtrojë Kina për të imponuar zgjedhjet e tajvanezëve në favor të saj.

Instituti Brookings në Uashington, një qendër për

studime mbi politikën dhe demokracinë globale, parashikon që vitin e ardhshëm do të jemi dëshmitarë të «një Perëndimi të egër informacioni dhe kundërinformacioni politik, i aftë për të manipuluar opinionet publike globale për shkak të aftësisë sonë të kufizuar për të dalluar të rremen, nga e vërteta”. Dhe ai raporton se problemi “do të bëhet edhe më i përhapur dhe i vështirë për t’u demaskuar falë imazheve dhe videove të krijuara me inteligjencë artificiale”.

Që Inteligjenca Artificiale arrin të ngrrejë besueshmërinë e “fake news” në shkallë e n-të tashmë është fakt. Këtë e tregojnë imazhet perfekte (dhe false, duke filluar me Ronaldon që mban lart flamurin palestinez) që ndotën Twitter-X disa orë pas sulmit terrorist me të cilin Hamasi tronditi Izraelin dhe botën më 7 tetor.

Një muaj më parë, një studim nga Microsoft dhe Universiteti i Maryland denoncoi dorën e inteligjencës kineze pas përhapjes në internet të lajmit të rremë se zjarret shkatërruese që shpërthyen në verë në ishujt Havai, ishin rezultat i një eksperimenti ushtarak amerikan. Në mediat sociale dhe në mbarë botën, shumë njerëz kanë pranuar teorinë se zjarret ishin produkt i një “arme të re klimatike” të testuar nga Pentagoni, një gënjeshtër e përforcuar në mënyrë efektive nga videot dhe fotografitë e krijuara me Inteligjencë Artificiale.

Në muajt e mëparshëm, Rusia kishte mbushur rrjetet sociale globale me postime që sugjerorin shifra të fryra për shpenzimet e SHBA-së në mbështetje të Ukrainës dhe përhapnin tezën se ato dollarë duhet të shpenzoheshin më mirë në interes të amerikanëve. Është një lojë që ekziston prej kohësh. Një studim nga Universiteti i Kembrixhit zbuloi se në prag të pushtimit të Ukrainës, 24 orë para 24 shkurtit 2022, përdoruesit e regjistruar të Twitter ishin rritur me mbi 50,000 – krahasuar me një mesatare ditore prej rreth 10,000. – dhe pothuajse të gjithë “profile jo njerëzish”, që mbështetnin Putinin.

Që nga viti 2022, Inteligjenca Artificiale ka bërë përparime gjigante. Dhe diktaturat e mëdha kanë investuar shumë propagandë në të. Këtë e demonstroi ajo video – sa efektive aq edhe e rreme – në të cilën Biden shpalli rifutjen e shërbimit të detyrueshëm ushtarak për të dërguar të rinjtë amerikanë në Ukrainë.

Me pak fjalë, keqinformimi është i fuqishëm dhe në këtë vit rekord zgjedhor rrezikon të ketë efekte katastrofike. Kjo, edhe sepse kundërmasat janë të kufizuara në masa modeste paliative. Që nga nëntori, Google ka vendosur se do t’u “kërkojë” përdoruesve të tij në YouTube të “raportojnë reklamat politike që përdorin imazhe, audio ose tekst të krijuar me Inteligjencë Artificiale”. Sigurisht që nuk do të mjaftojë. /

Panorama Italia (bota.al)

INTERVISTË EKSKLUZIVE me Bardhyl Mahmutin: Si u hoq cilësimi i UÇK-së si “organizatë terroriste”? (18)

‘Loja’ rreth përfaqësimit të UÇK-së në Konferencën e Rambujesë

Politologu Bardhyl Mahmuti, ish-përfaqësues politik i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, në intervistën ekskluzive dhënë “Epokës së re”, në vazhdimin e pjesës së tetëmbëdhjetë, ka folur rreth përfaqësimit të UÇK-së në Konferencën e Rambujesë dhe vërejtjeve që Adem Demaçi kishte rreth përmbajtjes së Deklaratës së Grupit të Kontaktit dhe lajmeve për mospjesëmarrjen e UÇK-së në këtë konferencë. “Refuzimi që të merrnim pjesë në konferencë do të rrëronte në mënyrë të pakthyeshme besimin që kishin krijuar diplomatët amerikanë dhe britanikë ndaj nesh dhe në këtë mënyrë do të shkonte huq tërë angazhimi i tyre për të hequr cilësimin paraprak të UÇK-së si ‘organizatë terroriste’”, ka theksuar Bardhyl Mahmuti, duke shtuar se: “Më në fund UÇK-ja bëri të ditur se do të ishte pjesë e delegacionit të Kosovës në këtë konferencë ndërkombëtare dhe kështu mbylli thashethemet!”.



PRISHTINË, 27 DHJETOR - “Epoka e re”: Megjithatë për Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës çështja e pjesëmarrjes në Konferencën Ndërkombëtare për Kosovën në Rambuje doli të ishte më e koklavitur sesa që kishit menduar? Më 30 janar, në Shkup, Përfaqësuesi i Përgjithshëm i UÇK-së në Prishtinë, z. Adem Demaçi u takua ministrin e Jashtëm të Mbretërisë së Bashkuar, Robin Cook. Pas takimit, z. Demaçi deklaroi se do të jepte përgjigje pasi ta kishte studiuar përmbajtjen e materialeve që iu dorëzuan. Në ndërkohë, z. Jakup Krasniqi i deklaroi “Washington Post”-it se UÇK-ja do të merrte pjesë në konferencë dhe më vonë u publiku lista e parë e atyre që do ta përfaqësonin UÇK-në në kuadër të delegacionit të Kosovës, në mesin e të cilëve ishte edhe emri juaj. Mirëpo, në konferencën me gazetarët të datës 2 shkurt, zoti Demaçi kritikoi përmbajtjen e Deklaratës së Grupit të Kontaktit dhe u deklarua se ai, personalisht, nuk do të shkonte në Rambuje dhe se do të rekomandonte mospjesëmarrje në Konferencën e Rambujesë. Mirëpo në të njëjtën ditë, UÇK-ja pranoi të merrte pjesë dhe publikoi një listë me emra të rinj të përfaqësuesve të saj në konferencë, ku nga lista paraprake u hoq emri i juaj dhe i Sokol Bashotës dhe u shtua Azem Sylja dhe Xhavit Haliti. Për çfarë arsyes ndodhën të gjitha këto gjëra?

Bardhyl mahmuti: Adem Demaçi kishte vërejtje të

shumta rreth përmbajtjes së Deklaratës së Grupit të Kontaktit. Megjithatë në këtë deklaratë thuhej se gjatë periudhës kalimtare, që duhej të zgjaste tri vjet, “ndalohej çfarëdo ndryshimi i njëanshëm i statusit kalimtar të krahinës dhe integriteti territorial i RFJ-

së dhe i shteteve fqinje” (pika 3 dhe 4 e deklaratës), Adem Demaçi dyshonte që një gjë e tillë mund të merrej si parim që nuk mund të negociohej as gjatë procesit kur të përcaktohej statusi përfundimtar i Kosovës. Nëse lexojmë me vëmendje

qëndrimet e Adem Demaçit në konferencën me gazetarë do të shohim se ai nuk i mbyll dyert e pjesëmarrjes së përfaqësuesve të tjerë të UÇK-së në këtë konferencë, siç e kanë prezantuar disa gazetarë tendencioz. Përkundrazi, ai deklaroi qartë se në kuadër të

UÇK-së **“ka njerëz të kualifikuar, të cilët mund të shkojnë dhe le të shkojnë. Le të përpiqen të arrijnë, të implementojnë diçka, në qoftë se atyre ua merr mendja se mund të arrijnë!”**

“Epoka e re”: A dinit se kush orkestroi fushatën e gazetarëve të tillë?

Bardhyl Mahmuti: Nuk e di se kush qëndronte prapa një fushate të tërbuar për ta paraqitur Adem Demaçin si pengesën kryesore për gjetjen e një zgjidhjeje politike, por shkrimet e tilla të korrespondentëve të agjencive telegrafike dhe mediave me peshë në skenën mediatike ndërkombëtare shkonin në interes të Serbisë, sepse krijuan përshtypjen e gabuar se edhe UÇK-ja ishte përgjegjëse për dështimin eventual të Konferencës së Rambujesë. Atë që mund të them me plot përgjegjësi është fakti se prezantimi i shtrembëruar i qëndrimeve të Adem Demaçit si refuzimi i pjesëmarrjes sonë në konferencë u përjetua shumë keq nga diplomacia amerikane dhe britanike, të cilët, në kuadër të takimit të Grupit të Kontaktit, kishin këmbëngulur për përfshirjen tonë në delegacionin e Kosovës.

“Epoka e re”: A ju kontaktoi dikush nga diplomatët lidhur me këtë?

Bardhyl Mahmuti: Po! Disa orë pas konferencës për shtyp të Zyrës së UÇK-së në Prishtinë, më telefonoi ambasadori Lawrence Rosin dhe më

Zëdhënësi i Shtabit të përgjithshëm të UÇK-së i tha gazetës “The Washington Post”

Jakup Krasniqi: “UÇK-ja pranon kushtet e Grupit të Kontaktit”

- Përfaqësuesit e lartë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës me dëshirë do të marrin pjesë në bisedime përkrah zyrtarëve shqiptarë, madje edhe përkrah Ibrahim Rugovës — “Në qoftë se jemi të gatshëm të bisedojmë me Milosheviqin, jemi të gatshëm që të bisedojmë edhe me njëri-tjetrin”, i tha Jakup Krasniqi gazetës “The Washington Post”
- Sokol Bashota: “Nuk do t’i dorëzojmë armët deri sa ta fitojmë pavarësinë”

Udhëheqës i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në një deklaratë, dhënë gazetës “The Washington Post”, tha se, me gjithë dhunën e fundit, ata janë të gatshëm që të pranojnë kushtet e planit paqësor të Perëndimit. Jakup Krasniqi, zëdhënës i UÇK-së, tha se ai mendon që “Milosheviqi do të refuzojë propozimin” dhe thotë se është “pesimist se zgjidhja politike mund të gjendet brenda afatit të cakutur”.

Sidoqë të jetë, tha ai, përfaqësuesit e lartë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës me dëshirë do të marrin pjesë në bisedime përkrah zyrtarëve shqiptarë, madje edhe përkrah Ibrahim Rugovës. “Në qoftë se jemi të gatshëm të bisedojmë me Milosheviqin, jemi të gatshëm që të bisedojmë edhe me njëri-tjetrin”, tha Krasniqi. Krasniqi përsëriti se UÇK-ja më herët ka kërkuar që para se të fillojnë negociatat, Qeveria serbe të lirojë të gjithë të burgosurit politikë dhe t’i tërheqë forcat e sigurimit nga Kosova. Në qoftë se fuqitë perëndimore premtojnë se këto kërkesa do të realizohen me siguri, pohoi Krasniqi “ne do të jemi të gatshëm që për popullin tonë dhe për interesat tona kombëtare të bëjmë çdo gjë dhe ta bëjmë këtë sa më shpejt”, shtoi ai. Krasniqi dhe bashkëluftëtarët e tij, Ramë Buja dhe Sokol Bashota, thanë se ata do të përshëndesin zgjidhjen e mundshme që do të mbështetet



“Në qoftë se jemi të gatshëm të bisedojmë me Milosheviqin, jemi të gatshëm që të bisedojmë edhe me njëri-tjetrin”, tha Krasniqi.

me vendosjen e trupave të NATO-s në Kosovë. “Në qoftë se vijnë (trupat) ne u garantojmë se prej nesh nuk do t’u ndodhë asgjë e keqe”, tha Krasniqi. “Ne jemi të vetëdijshëm se cili është armiku ynë, prandaj i mirëpresim ata si miq, si njerëz që vijnë këtu për të marrë shtet”. Sidoqë, ata shtuan se edhe pse UÇK-ja pajtohet për armëpushimin që do të arrijë me marrëveshjen politike, në këtë periudhë ajo nuk do t’i lëshojë armët nga duart. “Nuk do t’i dorëzojmë armët deri sa ta fitojmë pavarësinë”, tha Bashota.

Dy janë metharat më të mundshme ku NATO do të mund të ndërhynte për të sulmuar çelqet e caktuara të forcave serbe.

E para: Nëse dështon strategjia e grupit të kontaktit, ndërsa tjetra nëse përsëriten masakrat dhe vrasjet siç ishin ato të javëve të fundit. Lidhur me presionin ndaj UÇK-së, një zyrtar i lartë i NATO-s tha se janë dy qasje kyqje: E para: Eshhtë qasja politike, se cilën tashmë janë duke e zbatuar ndërm-

Në rast se arrihet marrëveshja paqësore për Kosovën NATO-ja dërgon mbi 20.000 trupa tokësore në Kosovë

Qeveritë e vendeve anëtare të NATO-s janë duke e shqyrtuar me njëjtë seriozitet mundësinë e dërgimit të trupave të tyre në Kosovë për të



REUTERS

Londër, 30 janar

Kryeministri britanik, Tony Blair (majtas), dhe nënkryetari amerikan, Al Gore (djathtas), para rezidencës së Blairit në “10 Downing Street” në Londër. Gore tha se NATO-ja është e gatshme që të përdorë forcën në Kosovë, nëse forcat serbe dhe ato shqiptare nuk i japin fund luftimeve dhe nuk arrijnë zgjidhje paqësore.



Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

Përzgjidhen 10 shpresat olimpike 2024

PRISHTINË, 27 DHJETOR - Bordi Ekzekutiv i Komitetit Olimpik të Kosovës (KOK) ka miratuar listën e komisionit të sportit për përzgjedhjen e 10 shpresave olimpike 2024 të cilët do të mbështeten nga Ministria e Kulturës, Rinisë

dhe Sportit (MKRS). Bursistët, të moshës 15-21 vjeç, vijnë nga sportet e xhudos, mundjes, taekwondosë, boksit dhe atletikës. Bursistët mbështeten me nga 150 euro në muaj, sipas rregullores së MKRS-së për mbështetjen e

10 shpresave olimpike. Gjatë muajit janar ose shkurt KOK-u do të përzgjedhë edhe dhjetëra bursistë shpresa olimpike, të cilët mbështeten nga KOK-u. Gjatë vitit 2023, 35 bursistë u mbështeten me nga 150 euro në muaj. 10

shpresat olimpike: Bleron Ademi (Taekwondo), Jon Gashi (Taekwondo), Blin Kuka (Xhudo), Uveys Nesimi (Xhudo), Donat Sylja (Boks), Taulant Jakupi (Boks), Lonisa Reka (Mundje), Elsa Nokici (Mundje), Sara Susuri



(Atletikë), Granit Ahmeti (Atletikë).

Prishtina përforcohet me Gjokajn, huazon Kurtajn dhe Bulliqin

FC Prishtina i ka përforcuar radhët e veta me portierin Altin Gjokaj. Ky i fundit ka thënë se ndihet krenar që është bërë pjesë e kryeqytetasve dhe se është i gatshëm për të konkurruar për pozitën e titullarit. “Jam i hapur për konkurrencë. Kam ardhur t’i tregoj vlerat e mia dhe ta tregoj tërë potencialin tim”, ka thënë Gjokaj

EPOKA E RE

Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 27 DHJETOR - Skuadra e Prishtinës është treguar aktive të mërkurën në tregun e transferimeve, pasi ka transferuar një futbollist dhe ka huazuar dy të tjerë. Kryeqytetasit e paraqitën portierin cilësor Altin Gjokaj, i cili së fundmi ishte pjesë e skuadrës së Drenicës në Ligën e Parë. 18-vjeçari nga Skenderaj, portier i Drenicës dhe

Përfaqësueses së Kosovës, i të gjitha kategorive zinxhir të saj, duke filluar nga U15 dhe deri U21, ka nënshkruar kontratë trevjeçare me Prishtinën. Gjokaj është shprehur i kënaqur që është bërë pjesë e Klubit të Prishtinës, derisa ka paralajmëruar se është i hapur për konkurrencë. “I falënderoj drejtuesit e klubit të Prishtinës që më dhanë mundësinë ta vesh fanellën e klubit më të madh në vend! Jam i hapur për



konkurrencë. Kam ardhur t’i tregoj vlerat e mia dhe ta tregoj potencialin tim”, ka thënë Gjokaj. Ndërsa sa iu përket huazimeve,

fjala është për Albion Kurtaj dhe Butrint Bulliqi. Kurtaj është huazuar në FC Ferizaj, ndërsa Bulliqi në skuadrën e Ligës së

Parë, Phoenix. “Albion Kurtaj është huazuar në FC Ferizaj, i cili është pjesë e ekipit tonë nga ky edicion kur ishte transferuar nga KF Llapi dhe ka regjistruar me skuadrën tonë 15 ndeshje zyrtare - 4 prej tyre si titullar. Butrint Bulliqi, portieri i tretë i skuadrës së parë dhe anëtar i kampionëve vjeshtorë të Prishtina U21, huazohet në Phoenix të Banjës së Istogut. Bulliqi me U21 të Prishtinës ka regjistruar tri paraqitje si titullar. FC Prishtina i uron sukses në skuadrat huazuese!”, thuhet në njoftimin e klubit kryeqytetas.

Skuadra e Prishtinës sezonin vjeshtor e mbylli në vendin e pestë me 26 pikë të grumbulluara, duke regjistruar pesë fitore, njëmbëdhjetë barazime dhe dy humbje.

Distria Krasniqi e mbyll vitin në vendin e parë të renditjes botërore



PRISHTINË, 27 DHJETOR - Xhudistja e Kosovës, Distria Krasniqi, e ka mbyllur vitin 2023 si lidere e renditjes botërore të xhudistëve. Kampionia olimpike e mbylli këtë vit të suksesshëm që e kishte në vendin e parë pasi i grumbulloi 7 715 pikë. “Ajo është një dhuratë që vazhdon të na dhurojë gjëra. Distria Krasniqi e gjeti lavdinë olimpike në kategorinë deri në 48

kilogramë, ndërsa më pas ia vuri syrin një sfidë të re, kalimin në peshat deri në 52 kilogramë, që ishte e njohur më parë në Kosovë pasi mbulohej nga Majlinda Kelmendi”, thuhet në njoftimin e Unionit Evropian të Xhudos. Krasniqi e nisi vitin në mënyrë fantastike duke e fituar medaljen e artë në “Paris Grand Slam”, për ta pasuruar koleksionin e saj të medaljeve. Ajo fitoi edhe medalje të tjera

gjatë vitit, ndërsa tash do të bëhet gati për Olimpiadën e Parisit, ku synon medalje prapë. Rezultatet e “Disit” në vitin 2023: Medalja e artë në “Paris Grand Slam”, kurse medaljen e argjendtë e fitoi në “Tbilisi Grand Slam”, “Hungary Masters”, “Baku Grand Slam”, “Kampionati Evropian” dhe medaljen e bronzit në Kampionatin e Hapur Evropian në Prishtinë.

Kosova e luan ndeshjen e parë në vitin 2024

PRISHTINË, 27 DHJETOR - Periudha festive e fundvitit nuk është periudhë pushimi për Federatën e Hendbollit të Kosovës dhe për ekipet përfaqësuese. Që në nismë të vitit 2024 përfaqësueset e Kosovës kanë sfida shumë të rëndësishme ndërkombëtare. Madje Kosova do ta luajë ndeshjen e parë në kuadër të

EHF-së në vitin 2024. Bëhet fjalë për Përfaqësuesen U18 të hendbollistëve që më 5 janar nga ora 12:00 luan ndaj Zvicrës në Shkup. Ndeshja u takon kualifikimeve për Kampionat Evropian. Kosova U18 është në Grupin B, ku bëjnë pjesë edhe Maqedonia e Veriut dhe Sllovakia. Më 6 janar nga ora 12:00, Kosova U18 luan me

Sllovakinë. Ndërsa më 7 janar nga ora 15:00 është ndeshja Kosova - Maqedonia e Veriut. Dy të parët në grup avancojnë në evropian, ndërsa dy përfaqësueset e tjera garojnë në Evropianin e Divizionit B. Me të nisur viti do të grumbullohet edhe Përfaqësuesja A e Kosovës në hendboll. Në kuadër të raundit promovues për

Evropianin 2026, hendbollistët tanë më 10 janar e presin Britaninë e Madhe në Prishtinë. Ndeshja në Britani të Madhe është më 13 janar. Përfaqësuesja më e mirë pas dy ndeshjeve avancojnë në kualifikimet e rregullta. Kështu për Federatën e Hendbollit të Kosovës fillimi i vitit do të jetë me plot aktivitete. Synimi është



kalimi i Britanisë së Madhe dhe paraqitja e suksesshme e djemve të Kosovës U18 në kualifikimet në Shkup.

Përfundon afati kalimtar në basketboll

PRISHTINË, 27 DHJETOR - Më 25 dhe 26 dhjetor ka qenë i hapur afati kalimtar në basketboll te meshkujt. Klubet e elitës së basketbollit kanë bërë disa përforcime me vendorë, duke bërë që stinori pranveror të jetë edhe më interesant, kurse për lojtarët e huaj afati është deri më 29 shkurt 2024. Sigal Prishtina ka transferuar Henrik Sirkon nga Golden Eagle Ylli, Malcolm Armstead nga Peja dhe Qëndrim Demin nga Drita. Golden Eagle Ylli ka transferuar Ervin Mullaaliun nga Proton Cable Prizreni. Peja ka transferuar Jetmir Zeqirin nga Sigal Prishtina dhe Musab Malën nga Proton Cable Prizreni. Bashkimi ka transferuar Lejson Zeqirin nga Sigal Prishtina. Vëllaznimi ka huazuar Daniel Lekndreaj nga Sigal Prishtina. Istogu ka transferuar dyshen vendore Drilon Shala nga Golden Eagle Ylli dhe Donat Rexhepin nga Vëllaznimi.



10 vjet nga aksidenti, Ralf Schumacher: Asgjë nuk është më si më parë

HURTH, 27 DHJETOR - Kur kanë kaluar 10 vjet nga aksidenti tragjik me ski, jeta e Michael Schumacherit dhe familjes kanë ndryshuar totalisht. “Asgjë nuk është më si më parë”, janë fjalët e vëllait të tij, Ralf Schumacher, gjithashtu një ish-pilot i Formulës 1. “Më mungon Michaeli i asaj periudhe. Jeta ndonjëherë nuk është e drejtë me njerëzit. Michaeli në jetën e tij shpesh kishte pasur fat, por më pas erdhi ai aksident dramatik”, shprehet më tej Ralf Schumacher. Duke folur për “Bild”, Ralf Schumacheri ka shtuar: “Falë Zotit, përmes disa mjekimeve moderne, është arritur të bëhet diçka e mirë. Pavarësisht prej kësaj, asgjë nuk është më si më parë”. Michael Schumacheri u aksidentua teksa bënte ski në Francë. Ai pësoi një goditje të fortë në kokë dhe 7 herë kampioni i botës në Formula 1 kreu dy



operacione në kokë. “Mund të them vetëm se aksidenti i tij përfaqëson një moment të keq dhe drastik edhe për mua. Kjo që ndodhi ndryshoi tërësisht familjen tonë. Ishim të pafat, madje edhe Mick, që asokohe ishte një fëmijë i vogël”, ka deklaruar Ralf

Schumacher. Duke folur për marrëdhënien mes tyre, Ralf ka shtuar: “Më dha gjithë përvojën e tij. Kisha mundësinë të mësoja nga më i miri. Kur ishim të vegjël flinim shpesh në të njëjtën dhomë. Michaeli ka qenë gjithnjë pranë meje, ndaj më mungon shumë”.

Indiana rikthehet te suksesi, Minnesota ruan kreun në Perëndim



OKLAHOMA, 27 DHJETOR - Minnesota vijon t'i ruajë pozitat në krye të renditjes në Konferencën e Perëndimit pavarësisht prej humbjes me rezultat 129-106 në fushën e Oklahomas. Dy skuadra pretendente në këtë kah të NBA-së, ku për vendasit të gjithë

titullarët realizuan mbi 10 pikë (Alexander Shai me 34 pikë më i miri). Fiton edhe Brooklyn, që falë 24 pikëve të Johnsonit, mundi 118-112 Detroitin jashtë fushës. Rikthehet te fitorja ekipi i Indianas, që mposhti me rezultat 123-117 Houstonin. Për miqtë u dallua

Haliburton me 33 pikë dhe 10 asistime. Pas kohës shtesë triumfoi skuadra e Memphisit, që mundi me shifrat 116-115 New Orleansin, ndeshje ku u dalluan Moranti me 31 pikë e Bane me 27 pikë. San Antonio mbetet në fund të renditjes në Perëndim pas humbjes 130-118 nga Utah Jazzi (Markkanen 31 pikë). Skuadra e Chicagos, falë 25 pikëve të DeRozanit, mundi 118-113 Atlantan, ndërsa Portlandi fitoi me rezultat 130-113 ndaj Sacramento (Fox 43 pikë, më i miri në fushë).

REZULTATET		
Detroit - Brooklyn		112-118
Washington - Orlando		119-127
Chicago - Atlanta		118-113
Houston - Indiana		117-123
New Orleans - Memphis		115-116
Oklahoma - Minnesota		129-106
San Antonio - Utah Jazz		118-130
Portland - Sacramento		130-113
Clippers - Charlotte		113-104

SHKURT

Shqipëria do të jetë pjesë e turneut miqësor në Algjeri

Kombëtarja shqiptare e futbollit me shumë gjasë përgatitet në prag të Evropianit 2024 do t'i zhvillojë në Algjeri. Bëhet fjalë për dy miqësore në muajin mars të cilat do të jenë dhe një test i mirë për trajnerin Silvinjo para se të nisët për në Gjermani. Kuqezinjtë do të përballen me kombëtaren joevropiane në një turne me katër skuadra. Përveç Shqipërisë, flitet se do të jetë Algjeria që do t'i presë të gjitha ndeshjet, ndërkohë që pjesë e turneut do të jenë edhe Afrika e Jugut dhe Bolivia. Dy ndeshje për çdo kombëtare me short caktohen për përballje gjysmëfinale, ndërsa fituesit shkojnë në finale, ndërkohë humbësit luajnë bashkë për vendin e tretë dhe të katërt. Edhe pse ende nuk ka diçka zyrtare nga Federata Shqiptare e Futbollit, mediet në Algjeri e bëjnë të sigurt. Fillimisht u përfol se kombëtarja shqiptare mund të luante me Turqinë dhe Zvicrën, por me të dyja federatat nuk u gjet gjuha e përbashkët për shkak të agjendave që këto dy ekipe kanë.

Guardiola trondit Cityn: Puna ime këtu ka përfunduar

Trajneri Pep Guardiola ka ende edhe një vit kontratë me Manchester Cityn, por ka hapur “dritën jeshile” për t'u larguar nga kampionët e Evropës dhe botës në futboll. “Kam ndjesinë se puna ime këtu ka përfunduar. E mendova këtë gjë pasi fituam Ligën e Kampionëve, më pas fituam edhe Superkupën e Europës dhe tani Botërorin për klube, dy trofe që nuk i kishim. Tani kemi gjithçka. Mendoj se është momenti për të blerë një libër dhe të nisim ta rishkruajmë historinë. Kjo është ajo që duhet të bëjmë”, u shpreh Guardiola.

Bayerni shpreh interesim për Varanen

Mbrojtësi Raphael Varane pritet të largohet nga Manchester Unitedi. Pasi e nisi mjaft mirë sezonin me gol kundër Wolverhamptonit, qendërmbrojtësi francez më pas hasi vështirësi për të gjetur hapësirë. Ai është aktivizuar vetëm në ndeshjet kundër Liverpoolit dhe Aston Villës që nga minuta e parë, me një total prej 915 minutash në sezon, duke përfshirë sfidat e Ligës së Kampionëve dhe Premierë Ligës. Me shumë mundësi mbrojtësi nuk do ta rinovojë kontratën me “Djajtë e Kuq”. Sipas asaj që raporton “Sport”, ish-lojtari i Real Madridit ka përfunduar në orbitën e Bayernit. Skuadra gjermane do të duhet të paguajë 20 milionë euro për ta blerë kartonin e tij nga Unitedi.

Arabia Saudite, super oferta për gjyqtarin e Serisë A

Jo vetëm investimet sportive dhe nënshkrimet e lojtarëve më të mirë: Arabia Saudite po punon për ta bërë kampionatin e Arabisë Saudite kampionatin më të mirë në botë. Për këtë arsye në shënjestër ka përfunduar edhe gjyqtari italian Daniele Orsato. Gjyqtari, i cili më 21 shtator të kaluar drejtoi një ndeshje mes Al-Ittihadit të Karim Benzemas dhe Al-Fatehit, duket se po tundohet nga një ofertë saudite. Sipas asaj që thuhet nga “Tuttosport”, në fakt do të kishte një ofertë marramendëse për të duke nisur nga sezoni 2024/25: të bëhet drejtues dhe ta drejtojë klasën e gjyqtarëve të Saudi Pro League.

Ronaldo konfirmohet golashënuesi më i mirë për vitin 2023

Cristiano Ronaldo do ta mbyllë vitin 2023 si futbollisti me më së shumti gola. Ylli portugez shënoi dy gola nga penalltia në fitoren e Al-

Nassrit ndaj Al-Ittihadit, për të shkuar në kuotën e 53 golave të shënuar gjatë këtij viti. Kështu, 38-vjeçari u konfirmua golashënuesi më i

mirë për këtë vit kalendarik. Ronaldo la prapa Harry Kanen (52 gola) e Kylian Mbappen (52 gola), si dhe Erling Haalandin (50 gola).

Kane dhe Mbappe nuk do të kenë më paraqitje për këtë vit, pasi në Gjermani dhe Francë ka përfunduar gjysma e parë e sezonit. Ndërkaq, Cristiano

Ronaldo ka mundësinë të shënojë edhe gola të tjerë për vitin 2023, pasi që Al-Nassri do ta luajë ndeshjen e radhës më 30 dhjetor ndaj Al-Taewonit.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, Kompania “Enex Group” Sh.p.k, Zahaq, Komuna Pejënë bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe komunën organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për Kompaninë “Enex Group” Sh.p.k.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 16.02.2024 në ora 10:00 në Shkollën Fillore e Mesme e Ulet "Zef Serembe", Fshatin Gllaviçicë Komuna Pejë, do të organizohet debat publik nga Kompania “Enex Group” Sh.p.k., në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunën për bazën për prodhimin e betonit.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

Zoom:
Join Zoom Meeting

<https://us05web.zoom.us/j/7012651943?pwd=JsyiMPR68pjZDwwrm2Z53eU1x9TEbu.1>

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për Kompaninë “Enex Group” Sh.p.k., Zahaq, Komuna Pejë, për bazën për prodhimin e betonit.

<https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin vnm.komente@rks-gov.net

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon në implementimin e projektit.



ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS
KOSOVO DOCTORS CHAMBER • LOKALSKA KOMORA KOSOVA

Oda e Mjekëve të Kosovës – Kosovo Doctors Chamber – Lekarska Komora Kosova

FTESË PËR OFERTË-RISHPALLJE

Lloji i Kontratës: ☐ Furnizim ☒ Shërbime ☐ Punë

Nr. i Prokurimit 18-23

Oda e Mjekëve të Kosovës është organizatë e pavarur profesionale e mjekëve që ushtron veprimtari profesionale mjekësore në Republikën e Kosovës.

OMK anëtareve të saj, i siguron standarde të larta të kodit të etikës dhe deontologjisë mjekësore, promovon dhe mbrojnë veprimtarinë e profesionistëve shëndetësor në institucionet shëndetësore publike, private si dhe publiko-private, siguron edukimin e vazhdueshëm profesional me qëllim të ngritjes së performancës shëndetësore dhe ofrimit të shërbimeve shëndetësore dhe shërbimeve tjera që kanë të bëjnë me kujdesin shëndetësor.

Oda e Mjekëve të Kosovës fton të gjitha kompanitë e interesuara që të paraqesin kërkesën e tyre për dosje të tenderit në adresën **Instituti A, Kati 2, QKUK, 10000 Prishtinë**, apo përmes emailit: info@omk-rks.org, me titullin:

Dosja për: Kontratë për përkthim dhe lekturim të dokumenteve të OMK-së

Në pajtim me Nenin 9, paragrafin 1 të Rregullores për Procedurat e Prokurimit në OMK:

☒ Afati për parashtrimin e ofertave është në kohëzgjatje prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e publikimit, për Kontratën me vlerë të madhe (që tejkalojnë shumën prej 10,000.00 €).

☐ Afati për parashtrimin e ofertave është në kohëzgjatje prej 10 (dhjetë) ditëve nga dita e publikimit, për Kontratën me vlerë të mesme (vlera e të cilave është deri në 10,000.00 €).

Njoftimin për kontratë mund ta shkarkoni në uebin e Odës: <https://omk-rks.org/>

Afatet Kohore.

Afati i fundit për tërheqje të dosjes së Tenderit është: **11.01.2024 ora 14:00.**

Afati i fundit për aplikim në Tender është: **11.01.2024 ora 12:00.**

Hapja e ofertave bëhet me datën: **09.01.2024 ora 14:00.**



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punës
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook



www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Genc Morina shpall te pavlefshme diplomën Q.K. “11 Marsi” Prizren.

- Muj Çoçaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - IX SHFMU “Lidhja e Prizrenit” Prizren.

- Kushtrim Baxhaku shpall te pavlefshme 3 dëftesa dhe diplomën Q.K. “11 Marsi” Prizren.

- Batjar Binakaj shpall te pavlefshme dëftesat dhe diplomën SHME “Ymer Prizreni” Prizren.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.

- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qira në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049/44-888-801 (viber)

- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë numër të tel: 049-440-466.

- Lëshoj banesën një dhomshe me qira, ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroi i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

